

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Autoritetet greke në “gjueti” të Alket Rizait
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/14/autoritetet-greke-ne-gjueti-te-alket-rizait/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:35:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:32:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0612d524aaa8942a966c9f551eeff26160af0bb5e79387b5d58ce7ecc8d0de6b
TEKSTI	6e1647593dcf6096f0edda534c954fd8f0dec98792120bf84420dfa105aa6d6c
PAMJA	1f5edf1485193679bd059d212a3cf395dec1aa610f17f0c4fef06b167bdf1891

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	531dfb61da6565784dfed13aafb9b495aea4892541d656b4b3523c1a031a37f9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/531dfb61da6565784dfed13aafb9b495aea4892541d656b4b3523c1a031a37f9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > KRONIKE

Autoritetet greke në “gjueti” të Alket Rizait

15:32 : 14/09/2026 në KRONIKE, RAJONI



Alket Rizai është sërish në kërkim nga Policia greke, pasi nuk u kthye në burgun e Domokos pas përfundimit të lejes. I dënuari shqiptar dyshohet se u përfshi në një incident me të shtëna në orët e para të së dielës, më 13 shtator, në Anavyssos, dhe që prej atëherë nuk është rikthyer në qeli. Kjo ishte leja e 17-të që Rizai kishte marrë që nga viti 2021. Në 16 rastet e mëparshme ai ishte kthyer në burg, ndërsa këtë herë vendosi të mos paraqitej në orarin e përcaktuar.

Por kjo nuk është arratisja e parë e bujshme e Alket Rizait. Ai është arratisur dy herë nga burgu i Korydallos me helikopter, së bashku me të shumëkërkuarin grek Vasilis Paleokostas, duke shkaktuar një prej skandaleve më të mëdha të sigurisë në sistemin penitenciar grek. Alket Rizai, i lindur më 24 maj 1978 në Balçik të Shqipërisë, u bë i njohur për autoritetet greke që në fillim të viteve '90, për çështje të lidhura me drogën.

Në vitin 2003, ai dyshohet se planifikoi vrasjen e biznesmenit grek Thanasis Koropiotis, pas një keqkuptimi që lidhej me partneren e tij. Sipas hetimeve, Rizai dhe bashkëpunëtorët e tij e çuan viktmin në një zonë të pyllëzuar në Atikën Verilindore, ku ai u vra dhe më pas trupi i tij u zhduk.

Rizai u arrestua rreth një muaj më vonë, në një apartament në Nea Filadelfia.

Arratisja e parë me helikopter

Më 4 qershor 2006, Rizai u arratis nga burgu i Korydallos me një helikopter, së bashku me Vasilis Paleokostas. Arratisja spektakolare shkaktoi reagime të forta në Greqi dhe ngriti pikëpyetje serioze mbi masat e sigurisë në burgje. Gjatë periudhës që ishte në arrati, më 26 gusht 2006, Rizai akuzohet se vrau në Peristeri 43-vjeçarin Konstantinos Koutelieris dhe 36-vjeçarin Ioannis Katsios. Sipas hetimeve, vrasjet u kryen me urdhër të një prej figurave të fuqishme të mafies greke, Vasilis Stefanakos. Rizai u arrestua disa ditë më vonë. Por historia u përsërit. Më 22 shkurt 2009, ai u arratis sërish me helikopter nga Korydallos, përsëri së bashku me Paleokostas. Pas disa muajsh në arrati, Rizai u arrestua në Grammatiko.

Lexo edhe:

[Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazhin grek](#)

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai. Si ndodhi ngjarja](#)

TË GJITHA



Autoritetet greke në “gjueti” të Alket Rizait

15:32 : 14/09/2026



Përmytet varka me emigrantë në jug të Greqisë, 1 i vdekur dhe 20 të zhdukur

15:29 : 14/09/2026



Balliu: Ron Yeffet i përfshirë në resortin e Ergys Agasit. Ja roli i Belinda Ballukut

15:09 : 14/09/2026




Apeli pranon kërkesën e Ilir Metës për të dalë nga kafazi

15:04 : 14/09/2026



Euro e nis edhe këtë javë në rënje, prek vlerën e 91.8 lekëve

14:57 : 14/09/2026



Goditi me grusht në bark qytetarin, Skender Hita pezullon nga detyra efektivin e “Shqiponjave”

14:39 : 14/09/2026



Thesari zhblokon pagat e GJKKO-së, ja cilët magjistratë përfitojnë

14:37 : 14/09/2026

Pengmarrja në burgun e Malandrinos

Në vitin 2013, Rizai tentoi një tjetër arratisje, këtë herë duke marrë peng pesë oficerë burgu në Malandrino. Pas rreth 24 orësh negociata, ai u dorëzua përfundimisht te autoritetet. Në janar 2021, pasi kishte përfituar pesë ditë leje nga burgu, ai u arrestua sërish pasi u pikas duke drejtuar një automjet BMW, së bashku me dy persona të konsideruar të rrezikshëm, gjatë një kontrolli të rastësishëm të trafikut.

Rizai është dënua dy herë me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit Penal me Pesë Anëtarë e Pireut për vrasjen e Konstantinos Koutelieris dhe Ioannis Katsios. Për arratisjen me helikopter nga Korydallos, ai ka marrë gjithashtu një dënim total prej 25 vitesh burg. Incidenti i fundit ndodhi në orët e para të së dielës, jashtë një bari plazhi në Anavyssos.

Rizai ndodhej jashtë burgut me leje kur dyshohet se u përfshi në përplasjen me armë. Policia greke po shqyrtonte pamjet e kamerave të sigurisë dhe provat e mbledhura në vendngjarje për të zbardhur se çfarë ndodhi. Dy persona mbetën të plagosur gjatë incidentit. Rizai duhej të kthehej në burgun e Domokos mëngjesin e së hënës, më 14 shtator, por nuk u paraqit. Për këtë arsye, ai është shpallur në kërkim dhe policia greke ka nisur operacionin për gjetjen dhe arrestimin e tij.

Etiketa: Alket Rizai autoritetet greke

Lajme të lidhura



Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazhin grek

09:04 : 14/09/2026



Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai. Si ndodhi ngjarja

22:49 : 13/09/2026



Europol godet rrjetin e trafikimit të emigrantëve në Ballkan, 7 të arrestuar në katër shtete

18:48 : 21/07/2026



Bastisje në burgun e Domokos, gjenden celularë dhe thika në qelitë e Alket Rizait dhe 'Sandrit'

12:36 : 25/02/2026



"Hija" e Alket Rizait në atentatin ndaj kryegardianit të Domokosit! Shënjestra, baxhanak me shqiptarin e arratisur

17:10 : 16/02/2026



Alket Rizai kërkon lirimin nga burgu në Greqi

20:06 : 11/04/2025

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt